

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E ARSIMIT**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

<b>Nr i Prokurimit</b>	<b>208 Udheheqesi-25-3443-1-1-1</b>
<b>Nr i brendshëm</b>	<b>208025016111</b>

Sa i përket tenderit për: **Blerja, furnizimi, montimi dhe instalimi i tabelave të mençura (smartboard) për qëllime arsimore për institucionet e arsimit parauniversitar**

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

**PI ER TECHNICAL Kft Branch in Kosovo**

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

**Rruga Ukshin Kovaçica, nr 11**

(Adresa)

**Prishtinë**

(Vendi)

**10000**

(Kodi postar)

**+36307568169**

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

**Elbasan Morina**

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

**infokosova@piertechnical.hu**

(Adresa elektronike)

**04.12.2025**

(Data e parashtrimt të ankesës)

  
**PI ER TECHNICAL KFT**  
Branch in Kosovo  
812019687  
PRISHTINE  
(Nënshkrimi dhe vula)

\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

#### 2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

\_\_\_\_\_  
(Emri i avokatit)

\_\_\_\_\_  
(Adresa e plotë)

\_\_\_\_\_  
(Numri i Telefonit)

\_\_\_\_\_  
(Numri i faks-it)

\_\_\_\_\_  
(Adresa elektronike)

\_\_\_\_\_  
(Data e parashtrimt të ankesës)

\_\_\_\_\_  
(Nënshkrimi dhe vula)

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës].

**Publikimi i njoftimit për kontratë: 02.05.2025**

**B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara: 28.07.2025**

**B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara: 17.11.2025**

**B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara: 24.11.2025**

**Hapja e ofertave është parashikuar të bëhet me datën e 04.12.2025**

**Kërkesa për rishqyrtim është dërguar me datën 27.11.2025, ndërsa vendimi për aprovim është dërguar me dt.03.12.2025**

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

\_\_\_\_\_  
Nuk ka hapje të ofertave

## 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

## 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Ne kemi bërë kërkesë për rishqyrtim, të cilën AK-Ministria e Arsimit e ka refuzuar si të pa bazuar. Bashkangjitur gjeni kërkesën për rishqyrtim dhe vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim.

## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

**Neni 1 Qëllimi**  
**Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi**  
**Neni 27 Dosja e Tenderit**  
**Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale**  
**Neni 4 - i RRPP nr.001/2022**  
**Neni 17 i RRPP nr.001/2022**  
**Neni 24.9 i RRPP nr.001/2022**  
**Neni 37 i RRPP nr.001/2022**

\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjabë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Njoftimi për kontratë B05 ishte publikuar me datën 02.05.2025, e që nga ajo datë procesi i kësaj procedure është stërzgatur për shkak se AK-Ministria e Arsimit po vendos kërkesa të pa

arsyeshme, diskriminuose dhe favorizuese në dosjen e tenderit. Për këto kërkesa OE dy herë kanë dërguar ankesat e tyre në OSHP dhe në të dy herët Organi Shqyrtues i Prokurimit i kishte aprovuar dhe ishte detyruar AK-Ministria e Arsimit të bëjë ndryshimin e kritereve dhe specifikave të dosjes së tenderit, mirëpo AK-ja në njërin anë po i bën disa ndryshime, ndërsa në anën tjetër po vendos kritere tjera diskriminuose.

Me datën 03.12.2025 kemi pranuar vendimin e AK-Ministria e Arsimit, ku në vendim shënohet se refuzohet si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim e parashtruar nga ne.

Arsyetimi i autoritetit kontraktues është krejtësisht i pa bazuar, për më tepër arsyetimi i saj në vendim për refuzim tregon qartë edhe një herë favorizimin që po i bëhet një kompanie të caktuar.

AK-Ministria e Arsimit në vendimin e saj e ka shënuar se:

1. **Kërkesa për mostra është e lejuar sipas LPP dhe RRPP 01/2022, Neni 37.2, dhe Sipas Neni 69.2.4 të LPP-së Nr. 04/L-042, mostrat e produktit janë kërkuar të nevojshme për vlerësimin teknik të ofertave ku qartë thuhet se mostra mund të kërkohen kur justifikohen nga natyra e mallrave dhe specifikave teknike.**
2. Në këtë procedurë bëhet fjalë për pajisje teknologjike të ndjeshme (smartboard), ku:
  - o cilësia e ekranit,
  - o ndjeshmëria e prekjes,
  - o rezolucioni,
  - o përputhshmëria me kërkesat didaktikenuk mund të vlerësohen vetëm me dokumente teknike.
3. **Mostrat nuk janë vendosur për të favorizuar një OE, sepse:**
  - o kërkesa vlen njësoj për të gjithë OE-të,
  - o të gjithë OE-të kanë mundësi të sigurojnë mostra nga prodhuesit përkatës,
  - o specifikat janë standarde ndërkombëtare jo kufizuese.
4. Në vendimin e OSHP-së të mëparshëm **nuk është ndaluar kërkesa për mostra**, por janë kërkuar vetëm qartësime procedurale – të cilat MASHT i ka zbatuar.
5. MASHT, si AK, ka detyrimin të sigurojë që pajisjet të jenë funksionale dhe të kualitetit të lartë – kjo **kërkon domosdoshmërisht testim fizik**, e jo vetëm certifikata.

Në arsyetim shënohet se në vendimin e OSHP-së të mëparshëm nuk është ndaluar kërkesa për mostra, por janë kërkuar vetëm qartësime procedurale të cilat MASHT i ka zbatuar. Ky konstatim tregon jo profesionalizmin e AK dhe gjithashtu tendencën për manipulim me pretendime ankimore. Në vendimin e fundit të OSHP nuk ka mundur të ndalohet kërkesa për mostra, pasi që një kërkesë e tillë nuk ka ekzistuar, pra në dosjet e kaluara nuk është specifikuar kërkesa për mostra, mirëpo për qudi AK i është kujtuar pas plot 6 muajve, të vendos si kërkesë që të prezantohen mostrat. Si mund të interpretohet një veprim i tillë i AK-Ministria e Arsimit, përveç se favorizim i një kompanie të caktuar.

Njëkohësisht nuk qëndron edhe fakti se OSHP kishte kërkuar vetëm qartësime procedurale, mirëpo ishte kërkuar qartë që të ndryshohen/largohen kërkesat e dosjes së tenderit të cilat kanë qenë kufizuese. AK po mundohet të vë në lajthitje edhe OSHP me këto arsyetime krejtësisht të pa baza.

Në vazhdim të arsyetimit AK-Ministria e Arsimit shënon:

OE pretendon se 10 ditë nuk janë të mjaftueshme për prodhim të mostrave.

MAShT sqaron:

- OE-të zakonisht furnizohen nga **prodhues ndërkombëtarë me produkte standarde**, prandaj nuk kërkohet prodhim i veçantë apo specifik vetëm për tenderin.
- Mostrat janë **produkte identike** me ato që OE pretendon të ofertojë, prandaj çdo OE që realisht ka kapacitet furnizimi duhet t'i ketë ose t'i sigurojë përmes distributorëve të autorizuar.

**Pra, afati është i arsyeshëm dhe nuk përbën pengesë reale teknike ose ekonomike.**

Ky arsyetim është i pa bazë po ashtu, sepse prodhues të ndryshëm posedojnë produkte standarde me specifikat të cilat do të ishin sipas pretendimeve tona, por në këtë rast specifikat janë hartuar për një prodhues të caktuar, andaj jo të gjithë prodhuesit mund të posedojnë produktin me specifikat e AK-Ministria e Arsimit.

Arsyetimi tjetër:

#### **V. MBI PRETENDIMIN SE B54 NUK ËSHTË PUBLIKUAR**

Pretendimi nuk qëndron.

- Ndryshimet në dosjen e tenderit kanë qenë **teknike dhe jo-substanciale**, prandaj nuk kërkohet B54 sipas udhëzimeve të ZPP-së.
- Statusi “në apel” është pjesë e procesit të menaxhimit të ankesave në platformë, dhe **nuk ndikon tek vlefshmëria e FDT-së finale të publikuar.**

Kjo gjë po ashtu nuk qëndron sepse AK, kishte larguar disa kërkesa nga FDT, të cilat janë kërkesa kualifikuese, pra nuk janë bërë ndryshime teknike siç i quan AK. Edhe në këtë rast AK-Ministria e Arsimit po e vërteton edhe një here se pretendimet tona qëndrojnë, sepse këtu po favorizohet një kompani e cila i posedon produktet sipas kërkesave të saj, sepse AK-ja qëllimisht po devijon në tërësi nga faktet të cilat vërtetohen qartë nga një analizë në platformën E-Prokurimi dhe kur analizohet vendimi i fundit i OSHP.

Arsyetimi tjetër:

#### **VI. SQRIMET PËR NENIN 5.1 DHE 5.2 – JO SHKELJE, POR PJESË E PLANIT TË IMPLEMENTIMIT**

Pretendimi se nuk ka qartësi për implementimin nuk krijon shkelje të LPP-së.

- Plani i implementimit për 36 muaj është pjesë e **fazës së ekzekutimit të kontratës**, dhe jo kriter për kualifikim apo për konkurrencë.
- Këto qartësime jepen pas nënshkrimit të kontratës në koordinim me MAShT dhe institucionet arsimore.
- Specifikimi i rafinuar sipas viteve (2026–2028) nuk është kërkesë ligjore, dhe as nuk ndikon në përgatitjen e ofertës financiare ose teknike.

Ky arsyetim po ashtu nuk qëndron sepse gjëra të tilla për implementim të kontratës duhet të qartësohen para ofertimit, sepse informata të tilla ndikojnë direkt në çmimin ofertues të OE.

Ndërsa sa i përket arsyetimeve tjera të AK-Ministria e Arsimit, për pretendimet tona për specifikat teknike, sqarojmë se e njëjta nuk ka mundur të jep asnjë dëshmi e cila është e mbështetur në legjislacionin primar dhe sekondar të LPP, por në të gjitha arsyetimet është mundur të favorizoj një kompani të caktuar.

Kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit-OSHP, që të analizoj në detaje pretendimet tona dhe rrjedhën e këtij aktiviteti të prokurimit dhe të detyroj autoritetin kontraktues-Ministria e Arsimit, që të veproj në harmoni me dispozita ligjore, pasi që nëse këto shkelje nuk do të merren parasysh ne jemi të detyruar që këto shkelje ti drejtojmë edhe në organet tjera më të larta, pasi që po na pamundësohet ofertimi me kërkesa absurde dhe jo në harmoni me legjislacionin primar dhe sekondar të LPP-së, pasi që po pamundësohet konkurrenca e hapur në këtë aktivitet.

AK-Ministria e Arsimit, që nga inicimi i këtij aktiviteti të prokurimit ka vepruar në mënyrë kundërligjore, e të njëjtën gjë po e bën edhe tani. Me dt.10.11.2025 në ora 15:18 AK ka publikuar dosjen e re, ndërsa për të i vënë në lajthitje OE të cilët mendojnë të ofertojnë në këtë procedurë pasi që po në të njëjtën datë 10.11.2025, por tani në ora 15:29, ka publikuar dosjen tjetër, e ku në dosjen e fundit ka bërë një ndryshim nga i cili kompanitë ofertuese mund edhe mos ta kenë parë.

Shih, foton më poshtë:

Nr.R.	Emërtimi	Gjuha:	Hape	Data
13.	Dosja e Tenderit shqip (12) (2).Doc	Shqip		10.11.2025. 15:29
12.	Dosja e Tenderit shqip (12) (2).Doc	Shqip		10.11.2025. 15:18

Në momentin që është publikuar dosja e re në ora 15:18, ne e kishim shkarkuar të njëjtën dhe kemi vazhduar të bëjmë analizën se a është vepruar konform vendimit të OSHP-së. Një ditë më vonë ne e kemi shkarkuar dosjen përsëri, mirëpo tani gjatë analizës ne e kemi vërejtur që AK, ka bërë një ndryshim i cili ndryshim është jo në harmoni me LPP.

AK në dosjen e re tek neni 27.1 i FDT-së, në vendin ku është e detyruar të shënoj datën dhe orën e dorëzimit të ofertave, e ka shtuar një kërkesë tjetër, ku tani ka kërkuar mostra.

Hapja e Tenderit	27.1	Hapja e tenderit do te bëhet me <b>21.11.2025</b> në 13:00 orë Vendi: <b>MASHTI</b> , mostrat janë obligativ mostrat të ofrohen në MASHT kati i III 12:00
------------------	------	---

Këtë veprim të AK-Ministria e Arsimit ne e shohim si tendencë për të favorizuar një kompani të vetme e cila i posedon mostrat e kërkuara. Përveç faktit që vendi ku është vendosur kërkesa është jo në harmoni me LPP, e njëjta nuk ka kërkuar fare mostra tek kapaciteti teknik dhe profesional apo edhe tek specifikimet teknike.

Kur shikohen dosjet e kaluara dhe përkatësisht dosja e dt.10.11.2025 e orës 15:18, aty nuk figuron fare mostra, mirëpo kur analizohet dosja e fundit e orës 15:29, shihet se janë kërkuar edhe mostra. Pra këtu shihen tendencat e AK-Ministria e Arsimit që të favorizoj një OE i cili është në dijeni që një ndryshim i tillë ka ndodh.

Për më tepër për të fshehur faktin se është bërë një ndryshim i tillë, AK statusin e këtij aktiviteti të prokurimit e ka lënë ende në apel, ndërsa nuk ka publikuar fare B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara..

Shih foton nga prokurimi:

Autoriteti kontraktues	Numri i prokurimit	Emërtimi	Lloji i procedurës	Vlera e parashikuar	Data e Mbylljes	Statusi	FPP (CPV)
MINISTRIA E ARSIMIT	208 Udhëheqësi-25-3443-1-1-1	Blerja, furnizimi, montimi dhe instalimi i tabelave te mençura (smartboard) për qëllime arsimore për institucionet e arsimit parauniversitar	Procedurë e hapur, Vlerë e madhe	8,500,000.00	06.08.2025 13:00	Në apel	30190000-7

Ky veprim i AK-Ministria e Arsimit është në kundërshtim të plotë me **Nenin 24- Ofrimi i informacioneve shtesë ose sqarimeve dhe zgjatjet e afateve kohore.**

Në këtë nen shënohet: 24.9 Nëse është e domosdoshme që procedura e prokurimit të pezullohet gjatë fazës së tenderimit për shkak të pranimit të një ankese nga OE, atëherë ZPP nëpërmjet funksionit “Ankesat” pezullon procedurën duke dërguar statusin e procedurës “në apel”.

**d. përdoruesi i sistemit (ZPP) pas vendimit mbi ankesën duhet që nëpërmjet korrigjimit të procedurës (B54) të bëjë ndryshimin e statusit të procedurës dhe të bëjë çfarëdo ndryshimi të nevojshëm për procedurën përkatëse.**

Sipas pikës d. të nenit të përmendur më lartë AK janë të detyruara të bëjnë korrigjimin B54 dhe ndryshimin e statusit, mirëpo kjo gjë nuk ka ndodhur qëllimisht nga AK.

Pra këtu shihen shkeljet që janë bërë nga AK gjatë zhvillimit të procedurës, ndërsa për kërkesat diskriminuese të cilat janë vendosur, ne do ti japim argumentet tona si më poshtë:

Pasi që një OE kishte parashtruar kërkesë për rishqyrtim me dt.14.11.2025, AK-Ministria e Arsimit, kishte bërë disa ndryshime në dosje të tenderit ku e kishte larguar kërkesën për mostra.

Tani AK-ja përsëri me dt.24.11.2025 ka publikuar dosjen e tenderi ku përsëri ka vendosur kërkesën për mostra, ku tani ka kërkuar 2 mostra edhe pse specifikat janë të njëjta për të dy lotet, pra me qëllimin e vetëm që të favorizoj OE të cilin ka përzgjedhur për aktivitetin e prokurimit.

Siç e sqaruam më lartë tek neni 27.1 i FDT-së janë kërkuar mostra.

Kur e kemi parasysh faktin se në dosjet e kaluara që nga publikimi i këtij tenderi nuk janë kërkuar mostrat dhe kur kemi parasysh kohën shumë të shkurtër për ofertim që nga data e publikimit të dosjes së re, kuptohet se mostrat kërkojnë kohë të prodhohen, ne si kompani mendojmë që për këtë tender duhet të largohet në tërësi kërkesa që mostrat të dorëzohen para ofertimit.

Koha për përgatitjen e mostrave që nga publikimi i dosjes së re e deri tek data e ofertimit është vetëm 10 ditë, kohë kjo që është shumë e shkurtër për të prodhuar mostra me specifikat e kërkuara.

Kërkesa jonë është e bazuar në nenin Neni 37-Mostrat e tenderëve, të RRPP-së 01/2022, sepse në pikën 37.1 shënohet që: **Dokumentet e tenderit në përgjithësi duhet të shmangin kërkesën për paraqitjen e mostrave, pasi kjo kërkesë dekurajon konkurrencën dhe rrit çmimet e ofertës. Përndryshe, tenderuesve duhet t'u kërkojë të konfirmojnë që produkti i tyre plotëson specifikimet e kërkuara dhe në mbështetje të bashkëngjitni certifikatat e duhura të testimi nga laboratorë të njohur testimi.**

**Në kërkesën për dorëzimin e mostrave, të njëjtat është e mundur të kërkojë nga OE të interesuar për pjesëmarrje që të dorëzojnë “fletën më të dhënat, përmbajtjen e specifikimeve të tabelave te mençura (smartboard), në kuadër edhe të garancionit për produktet.**

Në rast se kërkesa jonë nuk aprohet, ne kërkojmë që të shtyhet afati për dorëzim të ofertave deri me dt.30.12.2025, për shkak se ne jemi njoftuar nga prodhuesi që përgatitja e mostrës merr kohë të mjaftueshme.

Ne kërkojmë që të merren në konsideratë të gjitha pretendimet tona, të trajtohen me kujdes pasi që

pa dëshirën tonë do të jemi të detyruar të vazhdojmë me ankesa edhe në organet më të larta.

Në aneksin 1, është saktësuar sasia dhe të dhënat specifike për tabelat e mençura (smartboard), ndër të tjera afatet për fillimin/përfundimin e projektit është specifikuar të për periudhën (36) tridhjetë e gjashtë muaj.

Në nenin 5.2., të dosjes së tenderit është specifikuar:

5.2	Kushtet e dërgesës:
5.3	Afatet kohore për fillimin dhe / ose përfundimin e kontratës: 36 muaj

Tek ky nen nuk është dhënë ndonjë sqarim më i detajuar i formës së implementimit pasi që sasia është e madhe dhe do të ishte më e pranueshme se si është menduar furnizimi, montimi dhe instalimi i tabelave të mençura (smartboard), e më saktësisht në periudhën e kontratës duke vlerësuar rendësin e projektit, prandaj mendojmë se do të ishte e rrugës të specifikuar forma e implementimit e ndarë në periudha kohore. Këtë pretendim e parashtrijmë pasi që në dosje është kërkuar edhe:

Shërbimet pas shitjes	25.1	<i>Trajnimi për përdorimin e Smartbordve të stafit në shkollë pas furnizimit dhe instalimit të tyre.</i>
-----------------------	------	--

Prandaj kërkojmë që të bëhet një sqarim si shembull: Specifikat teknike LLOT I Prishtinë, Mitrovicë, Pejë:

- Prishtinë, viti 2026 furnizimi, montimi dhe instalimi i tabelave të mençura (smartboard), si dhe realizimi i trajnimeve në kuadër të stafit të shkollave.
- Mitrovicë, viti 2027 furnizimi, montimi dhe instalimi i tabelave të mençura (smartboard), si dhe realizimi i trajnimeve në kuadër të stafit të shkollave.
- Pejë, viti 2028 furnizimi, montimi dhe instalimi i tabelave të mençura (smartboard), si dhe realizimi i trajnimeve në kuadër të stafit të shkollave.

Tek neni 5.1, po ashtu është kërkuar:

Kushtet dhe kërkesat e dërgesës	5.1	Vendi i dërgesës është: <b>MASHT</b>
---------------------------------	-----	--------------------------------------

Në specifikën e lartcekur është specifikuar: (vendi i dërgesës është MASHT), kërkojmë që të sqarohet si është menduar të bëhet furnizimi. A duhet që dërgesa të bëhet në ndonjë depo të MASHT apo si, prandaj na sqaroni më hollësisht këtë kërkesë. Kur kemi parasysh që në këtë aktivitet të prokurimit është kërkuar që të bëhet edhe montimi i produkteve, prandaj për ne është e paqartë se si do të bëhet furnizimi dhe montimi i tabelave.

**Specifikimet teknike të detyruese po ashtu janë shumë kufizuese dhe diskriminuese pa lejuar ndonjë tolerancë fare:**

- **Touch-(Brush Mode: Dynamic Object Recognition)-** Kjo specifikë është shumë diskriminuese sepse po favorizohet prodhuesi i caktuar përkatësisht prodhues Samsung i cili e përdor këtë përshkrim. Fillimisht kërkesa është e paqartë se andaj e njëjta duhet të

qartësohet sepse qartësimi i funksionit final (jo i emrit të teknologjisë) lejon të ofrohet pajisjen me cilësi të lartë dhe të përmbush nevojat reale të përdoruesit.

Për shkak se termat “**Brush Mode**” dhe “**Dynamic Object Recognition**” janë të lidhura me terminologjinë tregtare të prodhuesve specifikë (Samsung Flip), ne kërkojmë saktësimin e funksionit përfundimtar që kërkon përdoruesi. Specifikimi teknik përmend “brush mode: dynamic object recognition”, i cili mund të interpretohet në mënyra të ndryshme nga një përdorues final. Interpretimi ynë është si vijon: Brush mode: Dynamic object recognition — një funksion në ekranet interaktive ku prekja identifikon në mënyrë të vazhdueshme llojin dhe madhësinë e kontaktit (p.sh. majën e hollë të stilolapsit, gishtin, sipërfaqen e gjerë/pellgun e pëllëmbës ose një brush të butë) dhe i përshtat automatikisht mjetet dhe vijën në kohë reale — duke kaluar mes stilolapsit/markërit/brush-it/gomës dhe duke rregulluar gjerësinë e vijës, opacitetin dhe teksturën — pa qenë e nevojshme që përdoruesi t’i ndryshojë manualisht mjetet.

Kërkojmë që të detyrohet AK-Ministria e Arsimit të sqaroj se a lejohet që “brush mode” të zëvendësohet me funksionet e produktit tonë të vizatimit, të njohjes së objekteve dhe të zgjedhjes së objekteve, nëse ato përmbushin të njëjtin funksion praktik.

- **Touch- Ekranit duhet të jetë hidrofobik (rezistent ndaj lagështisë dhe ujit), rezistent ndaj goditjeve dhe gërvishtjeve, dhe antimikrobial.**

Specifika e lartcekur është shumë e paqartë, për faktin se kur kemi parasysh që këto produkte janë tabela inteligjente për ambiente të brendshme, jo për ambiente të jashtme ku mund të bjerë shi/ujë, kërkojmë më shumë informacione në lidhje me veçorinë e rezistencës ndaj ujit. Pra kërkojmë të sqarohet, sa rezistente ndaj ujit duhet të jetë.

- **Touch speed 6.7ms;** 6.7 ms pa përcaktuar ndonjë tolerance është një vlerë jashtëzakonisht specifike teknike. Kjo shifër zakonisht është karakteristikë e një modeli të caktuar dhe në këtë rast po përdoret në mënyrë të pavend për të favorizuar një prodhues të vetëm. Në standardet e industrisë së kësaj fushe, deri në 6–10 ms konsiderohet e barasvlershme dhe ofron të njëjtën përvojë përdorimi. Prandaj për të siguruar konkurrencë të drejtë dhe të barabartë, kërkojmë që kjo specifikë të ndryshohet duke lejuar tolerancë nga 6-10 ms.

- **Display- Response time 6ms, LED, brightness 350cd/m<sup>2</sup>, contrast 4.000:1:**

Kërkesa për kohë përgjigjeje fiks 6 ms është tepër kufizuese, duke përjashtuar kështu pajisje të cilat ofrojnë performancë të barasvlershme. Kohët e përgjigjes së ekranit me tolerancë prej 6–7 ms nuk paraqesin ndryshim të dukshëm në performancë për përdorim në mjedise edukative, prandaj kërkojmë që të lejohet tolerancë prej 6-7ms me kontrast prej 4.000:1, me qëllim të hapjes së konkurrencës.

- **Feature: Procesori: Minimum 1.7 GHz:** Për këtë specifikë kërkojmë që të ndryshohet e njëjta për shkak se kërkesa për frekuencë minimale 1.7 GHz është më e lartë se sa është realisht e nevojshme për funksionalitetin e pajisjeve të kësaj kategorie dhe për sektorin edukativ. Në praktikë, procesorët me frekuencë 1.2–1.7 GHz ofrojnë performancë të njëjtë dhe të mjaftueshme, sidomos kur janë të gjeneratave të fundit, me arkitekturë më efikase dhe me shumë bërthama.

Prandaj për të siguruar konkurrencë të drejtë dhe për të shmangur kufizimin e pajisjeve që plotësojnë të gjitha kërkesat funksionale, kërkojmë që specifika e kërkuar të ndryshohet sipas kërkesës tonë.

- **Speaker-4x10W:** Kërkesa e AK-Ministria e Arsimit për “4 x 10W” është shumë specifike dhe mund të kufizojë pjesëmarrjen e prodhuesve të tjerë që ofrojnë konfigurime të barasvlershme të altoparlantëve.

Në praktikë, fuqia totale e altoparlantëve dhe cilësia e zërit mund të arrihet përmes konfigurimeve të ndryshme (p.sh. 2 x 15W, 2 x 20W, 2.1 system, ose 4 x 8W), të cilat ofrojnë performancë të njëjtë në mjedise mësimore, ku edhe do të përdoren këto produkte. Kërkojmë që për kërkesën e përmendur më lartë të lejohen të prezantohet 4x10ë ose i ngjashëm.

Dosja e tenderit është përgatit për të favorizuar një operator ekonomik andaj kjo dosje nuk është përgatit sipas nenit 27 të LPP dhe për më shumë kërkesa e kontestuar nga ne është në kundërshtim me neni 7 të LPP.

### **Neni 7** **Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi**

1. Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.
2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shume operatoreve ekonomik.
3. Pa e cenuar paragrafin e mësipërm, autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohet që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledh sasi të ose artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik.
4. Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik.
5. Autoriteti kontraktues nuk do të kërkojë nga operatori ekonomik që të (i) punësojë ose përdorë, ose të mos punësojë ose përdorë, ndonjë person ose ndërmarrje të veçantë për ekzekutimin e çfarëdo aspekti të një kontrate publike, ose (ii) që të furnizojë ose sigurojë, ose të mos furnizojë ose sigurojë, produkte ose shërbime të cilat rrjedhin nga një person, ndërmarrje ose rajon i veçantë gjeografik. Në rast se një kërkesë e tillë është veçanërisht e autorizuar nga ky ligj, ndonjë ligj tjetër ose marrëveshje ndërkombëtare, parametrat e saktë të një kërkesë të tillë do të saktësohen në kontratë ose në njoftimin e konkursit të projektimit, ftesën për pjesëmarrje ose tenderim, dhe në dosjen e tenderit.
6. Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; (ii) publikimin e rregullt, dërgimin dhe/ose disponueshmërinë e të gjitha njoftimeve, ftesave, informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj; (iii) eliminimin e praktikave, kriterëve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik; (iv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat për përzgjedhje dhe dhënie, duke përfshirë rëndësinë relative të secilës kërkesë dhe kriter të tillë, si dhe metodat e përzgjedhjes dhe dhënies të saktësohen në njoftimin e kontratës ose

konkursit përkatës të projektimit, në ftesën për tender ose pjesëmarrje dhe/ose në dosjen e tenderit; (v) që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies, dhe (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse.

Neni 7 ndalon vendosjen e kërkesave diskriminuese dhe favorizuese andaj duhet të largohen/ndryshohen kërkesat e kontestuara nga ne.

### **Ky aktivitet i prokurimit nuk është udhëheq sipas nenit 4 të Rregullores Nr. 001/2022 Për Prokurim publik.**

4.3 Të gjitha aktivitetet e prokurimit do të udhëhiqen në pajtim me parimet bazike si në vijim:

a. **Konkurrenca** – në mesin e Operatorëve Ekonomik duhet të inkurajohet në mënyrën më efektive dhe me efektive.

b. **Efikasiteti & Efektiviteti** – duhet të dëshmohet në procesin e prokurimit për të siguruar vlerën për parane për Autoritetin Kontraktues.

c. **Drejtësia/Mos-diskriminimi** – Të vepohet në mënyrë të drejtë gjatë tërë ciklit të prokurimit pa imponuar obligime të panevojshme ose pengesa për Operatori Ekonomik ose Operatori Ekonomik potencial. Të shmanget çdo trajtim që favorizon një furnizues të caktuar ose furnizues potencial.

d. **Objektivitet/Integritet/Sinqeritet** – Të deklarohet çdo konflikt i interesit që afekton ose paraqet afektim të vendimit; Të refuzohen dhurata, mikpritje dhe benefit të çfarëdo lloji nga Operatori Ekonomik ose Operatori Ekonomik potencial, të cilat mund të paraqesin kompromitim të objektivitetit ose integritetit.

e. **Transparenca** – Të sigurohen kushte dhe qasje të barabartë për të gjithë OE-të, duke informuar ata në mënyrë të hapur dhe transparente.

f. **Llogaridhënie** – Të ketë llogaridhënie për përgjegjësitë e përcaktuara, si dhe për vendimet e nxjerra, dhe regjistrimin e të dhënave të nevojshme.

g. **Profesionalizëm** – Të punohet me standarde të larta profesionale duke respektuar legjislacionin në fuqi dhe duke aplikuar praktikat më të mira.

Përfundimisht, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që të shqyrtoj ankesën tonë dhe të nxjerr:

### **VENDIM**

**APROVOHET**, si e bazuar ankesa e OE **PI ER TECHNICAL Kft Branch in Kosovo**

**NDRYSHOHET** dosja e tenderit dhe largohen kërkesat sipas pretendimeve tona dhe të vepohet sipas nenit 57.3 të LPP-së, duke u bërë zgjatja e afatit për dorëzim të ofertave.

## **9. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Dëmet mund të janë shumë të mëdha, kur kemi parasysh vlerën e parashikuar te tenderit!

## **10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.